



Pranuar / Dorezuar Prilimjen / Prilimjen Received / Delivered	18.05.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr. Prot. Bil. Prot. / Prot. No	Shkup. a Faqe / Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SK/M/SHICK	2902/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.253/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani –kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca -anëtarë, me Rushit Kajtazi –Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 253/2022, të datës 21.03.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit

të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 18.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e filluar me ankesën A.nr. 253/2022 të datës 21.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 21.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1459/2022 të regjistruar me numër A.nr.253/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.ZVVGJ/22/233 të datës 14.03.2022 të Komisionit për Rishqyrtim për Bashkëpunëtor Profesional të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimin ankimor për shkelje materiale të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjit për Gjykatat dhe Rregullores Nr.04/2021 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 25.03.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli më datë 13.04.2022 ka pranuar vetëm përgjigjën me shkrim (dy faqe A4) por jo edhe provat lidhur me çështjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.05.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.36/2022, me të cilin ka bërë shtyrjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankueses për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesën A. nr. 253/2022, e datës 21.03.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 09.03.2022, drejtuar Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi i datës 14.03.2022, i Komisionit për Rishqyrtim Përgjigje në ankesë e datës 2058/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të provave të ofruara vetëm nga pala ankuese dhe shqyrtimit të përgjigjes më shkrim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, vlerëson së janë plotësuar kushtet ligjore për pezullim të procedurës së filluar sipas ankesës A.nr.253/2022 të datës 21.03.2022, *sepse:*

Bazuar në shkresat e administruara të lëndës Kolegji ka gjetur së Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 30.11.2021 ka shpallur Konkursin Publik për Bashkëpunëtor Profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës, shtatëdhjetë (70) pozita, e në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi mirëpo sipas provave të administruara ankuesi nuk ka arritur ti mbledh pikët ë nevojshme për kalimin më sukses të testit më shkrim dhe rrjedhimisht nuk ka mundur të kaloj në fazat tjera të rekrutimit, andaj e njëjta kundër Njoftimit të rezultatit të testit më shkrim, më datë 09.03.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Rishqyrtim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky i fundit më Vendimin Nr.Ref: ZVVGJ/22/223 të datës 14.03.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar dhe ka vërtetuar rezultatin e shpallur më datë 07.03.2022 nga Komisioni për Rekrutim.

Kundër Vendimit Ref.ZVVGJ/22/223 të datës 14.03.2022 të Komisionit për Rishqyrtim për Bashkëpunëtor Profesional të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më pretendimin ankimor për shkelje ligjore për shkak së nuk është specifikuar statusi i pozitave të kërkuara së a janë nëpunës civil apo shërbyes publikë. Me tutje pretendon se në këtë procedurë ka pasur shkelje të dispozitave materiale të Ligjit Nr.06/055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjit Nr.06/054 për Gjykatat, dhe Rregullores Nr.04/2021 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, dhe se me vendimin e kundërshtuar nuk i është dhënë fare këshillë juridike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave fillimisht analizoj dispozitat ligjore që përcaktojnë kompetencën lëndore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Në këtë kontekst, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenit 6 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil; 1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur më zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.* Rrjedhimisht Kolegji ju referuar edhe Aktgjykimit KO171/2019 të datës 20 maj 2019 të Gjykatës Kushtetuese përkatësisht paragrafit 98 ku përcaktohet se: *... e drejta për të nxjerr një ligj të posaçëm për rregullimin e shërbimit civil në Republikën e Kosovës, buron nga paragrafi 1 i nenit 101*



të Kushtetutës, ndërsa e drejta për të nxjerr një ligj të posaçme për Këshillin buron nga paragrafi 2 i nenit 101 të Kushtetutës, ndërsa më paragrafin 99 të këtij aktgjykimi përcaktohet se: ... paragrafi 2 i nenit 101 ndërlidhët ngushtë dhe është derivat i paragrafit 1, i cili në mënyrë specifike kërkon që zbatimi i normave juridikë që rregullojnë shërbimin civil do të mbikëqyret nga një "këshilli i pavarur mbikëqyrës". Andaj në lidhje me këtë Gjykata vëren së fushëveprimi i Këshillit është i kufizuar dhe i lidhur ngushtë me ligjin bazik, respektivisht më ligjin që rregullon shërbimin civil.

Bazuar si më sipër, Kolegji analizoj dispozitat e ligjit bazik, respektivisht dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 5 ku përcaktohet se: *Personeli administrativ i punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokuroria është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, më përjashtim të gjyqtareve dhe prokuroreve, dhe rrjedhimisht sipas vlerësimit të Kolegjit, përjashtimisht gjyqtareve të gjithë të punësuarit tjerë në sistemin gjyqësor janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës, dhe ndaj tyre aplikohen rregullat e shërbimit civil dhe rregullat e legjislacionit përkatës. Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, si ligj bazik në kontekst të çështjes ju referua Ligjit për Shërbimin Civil, për shkak së më Aktgjykimin KO203/19 të datës 9 korrik 2020 të Gjykatës Kushtetuese është konstatuar së neni 2 paragrafi 3 (fusha e zbatimit) dhe neni 85 i Ligjit Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë nuk janë në pajtueshmëri më nenin 108 (Këshilli Gjyqësor i Kosovës) të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht në kuptim të fushës së zbatimit gjegjësisht përkufizimit të shërbimit civil, për sistemin gjyqësor ka mbetur në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës.*

Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes përgjigjes në ankesë të datës 14.03.2022 thekson së procedura e rekrutimit për shtatëdhjetë (70) bashkëpunëtor profesional në gjykata është bërë në bazë të Rregullores Nr.04/2021 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, ku në të përcaktohet se "*...kandidati i suksesshëm pas përzgjedhjes nga komisioni i rekrutimit lidh kontratë me Këshillin në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës... Andaj përgjigjen e japim në frymën e bashkëpunimit ndërinstitucional e jo si obligim i yni i cili rrjedh nga aktet normative të brenda të cilat i ka nxjerr Këshilli për këtë kategori të të punësuarve...".*

Kolegji, nga përgjigja në ankesë, ka gjetur së Këshillit Gjyqësor i Kosovës në mbledhjen e mbajtur më datë 15 nëntor 2021 ka miratuar Rregulloren Nr.04/2021 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes për bashkëpunëtorë profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës. Përveç tjerash më dispozitat e kësaj rregullore përkatësisht nenin 28 është përcaktuar se: *1. Kandidati i suksesshëm pas përzgjedhjes nga Komisioni për Rekrutim lidh kontratë të punës me Këshillin, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës. 2. Kontrata e punës lidhët për kohë të pacaktuar dhe konfirmohet pas përfundimit më sukses të periudhës provuese",* ndërsa më nenin 30 paragrafi 5 të kësaj rregullore përcaktohet se: *Bashkëpunëtori profesionale, sipas legjislacionit në fuqi, ka të drejtë të iniciojë procedurë në gjykatën kompetente ndaj vendimit përfundimtar të Këshillit për mos-konfirmim të pozitës pas periudhës provuese.*

Pra, Këshilli Gjyqësor i Kosovës më akt normativ ka përcaktuar rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes për Bashkëpunëtor Profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës, ku ndër të tjera më këtë akt normativ është përcaktuar së kjo kategori e të punësuarve, në njërën anë, dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës si organ i punësimit, në anën tjetër, lidhin kontratë punës sipas dispozitave të Ligjit të Punës, dhe rrjedhimisht i nënshtrohen këtij Ligji. Më dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht nenin 79 përcaktohet se: *Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur më vendimin më të cilin mendon së i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest punë në Gjykatën Kompetente,*



për dallim nga neni 81 i ligjit bazik që rregullon shërbimin civil, gjegjësisht Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.

Andaj, meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit normativ siç është rregullorja, dhe duke pas parasysh situatën juridike të krijuar lidhur me këtë pozitë të punës sipas Rregullores Nr.04/2021 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, rrethana këto që bëjnë të pamundur vendosjen në mënyrë meritore, dhe më qëllim të ruajtjes së pavarësisë funksionale dhe organizative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të garantuar më Kushtetutë, Kolegji vlerëson së janë përmbushur kushtet ligjorë për pezullimin e procedurës administrative sipas nenit 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht që të pezullohet procedura e vendosje meritore lidhur me ankesën A.nr.253/2022, deri në definimin e statusit të pozitës së bashkëpunëtorit profesional në gjykatë, nga organet respektive.

Bazuar në të gjeturat e lart theksuara, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konstaton se me evitimin e rrethanave që kanë sjellë pezullimin e kësaj procedure, Kolegji do të vendos në mënyrë meritore lidhur me ankesën e pezulluar sipas këtij vendimi.

Siç u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridikë:

Kundër vendimit të Këshillit, pala ë pakënaqur ë cila pretendon së vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ë ndalon ekzekutimin ë këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.253/2022

Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

Ankuesit

Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;

Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe

Arkivit të KPMSHCK- së;